



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE
TRANSPORTIT E TELEKOMUNIKACIONIT
KABINETI

Nr _____ Prot

MINISTRIA E FINANCEVE

KABINETI

Nr _____ Prot

U D H Ë Z I M

Nr 656P Datë 27.06 2006

**PËR
KRITERET E PROCEDURAT PËR PËRDORIMIN E
SUBVENCIONEVE SHETËTORRE PËR Sh.A. DHE NDËRMARJET E
UJËSELLËS KANALIZIMEVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.8379, datë 29.07.1998 "Per hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" Ligjit Nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" si dhe Udhëzimit Nr.2, datë 08.02.2006 "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2006" Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave:

U D H Ë Z O J N Ë

1. Subvencioni i Sh.A. Ujësllës dhe Kanalizime, Ndërmarrjeve të ujësllësave dhe sistemeve të ujësllës kanalizimeve të transferuara pranë njërive vendore të akordohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ujësllës Kanalizimeve bazuar në:

-Kërkesën për subvencion dhe relacionin për argumentimin e gjendjes financiare të shoqërisë nga titullari.

-Të dhënat tre mujore të nxjerra nga njësia e monitorimit pranë DPUK, për koston e shitjes së ujit, të ardhura, shpenzime dhe të dhëna të tjera, shtimi dhe rritja e kapaciteteve prodhuese (sipas tabelës bashkëlidhur ketij udhëzimi)

- 76'0

180/2000

2. Ky subvencion do të përdoret për të paguar pagat e punonjësve, sigurimet shoqerore sipas borderove, likujdim të faturave të energjisë elektrike sipas akt rakordimeve të bëra me KESH - SH.A. dhe të pranuar nga shoqëritë ujësjellës kanalizime dhe blerje klori. ^{Fondi që ngelet pas} likujdimit të zërave të mësipërm të përdoret për riparime makineri paisje.

3. Akordimi i subvencionit të bëhet deri në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe të gjitha shtesave të tjera të bëra me VKM.

4. Institucioni që bën shpërndarjen e subvencionit mund të përjashtojë nga dhënia e subvencionit të gjitha ndërmarrjet apo shoqëritë anonime që kanë realizime vjetore më tregues të arkëtimit nga shitja e ujit në masën me pak se 50% :

5. Institucioni që bën shpërndarjen e subvencionit për çdo vit duhet të përcaktojë një metodike të bazuar në treguesit e performancës të vitit paraardhës si dhe në të dhënat periodike, për të llogaritur sasinë e subvencionit që do të jepet për çdo ndërmarrje dhe sh.a. mbi bazën e shumës së akorduar në buxhetin e shtetit.

6. Do të trajtohen me subvencion edhe ato ndërmarrje, sh.a. dhe sisteme të ujësjellës kanalizimeve që kanë kaluar në pronësi dhe administrim të njësive të qeverisjes vendore.
Për këtë kategori do të ndiqen të njëjtat metodika për dhënie subvencioni.

7. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e cila bën çeljen e financimit, ushtron kontrole periodike lidhur me ^{zbatimin e} zbatimin e këtij udhëzimi nga shoqëritë dhe ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve. Në fund të vitit buxhetor por gjithsesi jo më vonë se 28 shkurti i vitit pasardhës në degën e thesarit paraqitet një kopje e relacionit të kontrollit. Për rastet kur kontrolli nuk ka përfunduar bëhet njoftim paraprak. Në rast të kundërt, dega e thesarit bën pezullimin e fondeve të reja për subvencion.

8. Udhëzimi Nr. 1082, datë 14.04.2000 "Për kriteret dhe procedurat për përdorimin e subvencioneve shtetërore për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve", shfuqizohet.


LULZIM BASHA

MINISTËR




RIDVAN BODE

MINISTËR



Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Tirane, tel: 04 256 091

180

